



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:005219

Datë: 31.03.2022

Numri i dokumentit: 02865889

PPP.nr.3/2022

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG, si përmbarimore, me gjyqtarin individual Blerim Istrefi, në çështjen juridike të kreditorit: KEK SH.A Rr. Nëna Terezë nr.36 Prishtinë, kundër debitorit F. K. Fsh S. K-Istog, për shkak të borxhit në shume prej 574.17 €, jashtë seance me dt. 31.03.2022 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

Propozimi i kreditorit KEK SH.A Rr. Nëna Terezë nr.36 Prishtinë, kundër debitorit F. K. Fsh S. K-Istog, për shkak të borxhit në shume prej 574.17 €, **KONSIDEROHET I TËRHEQUR.**

A r s y e t i m

Kreditori KEK SH.A Rr. Nëna Terezë nr.36 Prishtinë, ka ushtruar propozimin për përmbarim te përmbaruesi privat, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përmbarimi ndaj debitorit F. K. Fsh S. K-Istog, si në shkresat e lëndës me të cilën do të paguaj borxhin në shumë prej 574.17 €, për periudhën kohore 01.12.02.2009 e deri me dt. 20.03.2013, të gjitha këto ne afat 7 ditor nga dita e pranimit te urdhrit, ne të kundërtën të bëhet bllokimi i llogarive bankare, regjistrimin dhe sekuestrimi e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme dhe pas bllokimit dhe shitjes së sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, mjetet e mbledhura të transferohen në llogari te kreditorit, te gjitha këto te specifikuar ne propozimin për përmbarim te dt.20.12.2018.

Përmbaruesi privat me urdhrin përmbarimit P.nr.659/2018 të dt.20.12.2018, e ka lejuar propozimin për përmbarim në këtë çështje përmbarimore.

Debitori, F. K. Fsh S. K-Istog, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me shkrim, me kërkesë qe të anulohet urdhri përmbarimor pasi qe ka arritur

parashkrimi konform nenit 360 par 1 nen par.1.1 te LMD-së dhe 71 par.1.4 te LPP-së.

Pas prapësimit të ngritur nga debitori, kreditori, ka paraqitur përgjigje në prapësim duke e kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pa bazuar dhe të pa argumentuar me asnjë provë, propozimi për përmbarim është bërë për periudhën 24.06.2020 e deri më 11.11.2021, ku debitori ka bere pagës vullnetare dhe kemi ndërprerje te parashkrimit konform nenit 368 te LMD-së. Me tutje kreditori shton se kërkesa për prapësim nuk është ne harmoni me nenin 69 te LPP-së, po ashtu për ta vërtetuar validitetin e kësaj përgjigje konform nenit 73 te LPP-së kërkojmë qe te hapet seancë publike.

Gjykata Themelore në Pejë- Dega Istog, si përmbarimore me konkluzionin e dt. PPP.nr.3/2022 te dt. 03.02.2022 e ka urdhëruar kreditorin që brenda afatit prej 3 ditësh pas pranimit të konkluzionit, që kësaj Gjykate t'ia sjelli Kontratën për pagesën e borxhit me këse dhe deklaratën mbi dakordim te dt. 02.09.2016, në mënyrë qe të vazhdohet më tutje në këtë çështje përmbarimore, me paralajmërimin se nëse nuk veproni konform këtij konkluzioni, gjykata ne bazë të nenit 99 në lidhje me nenin 102 par. 3 të LPK-së propozimi për përmbarim do të konsiderohet i tërhequr, po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtresa do të hidhet poshtë.

Nga shkresat e lëndës, konstatohet se debitori, nuk ka vepruar brenda afatit të përcaktuar nga gjykata për sigurimin e dokumenteve te lartcekura, andaj duke u bazuar në nenin 102.par 3 të LPK-së, e ne lidhje me nenin 17 te LPP-së, gjykata propozimin e kreditorit KEK SH.A Rr. Nëna Terezë nr.36 Prishtinë, kundër debitorit F. K. Fsh S. K-Istog, për shkak të borxhit e KONSIDEROJ TË TËRHEQUR.

Andaj nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv te këtij aktvendimi në vështrim të nenit 99 par. 2 dhe 102 par.3 të LPK-së, e në lidhje me nenin 17 të LPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG
PPP.nr.3/2022, dt.31.03.2022

GJYQTARI
Blerim Istrefi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta ne ankese, ne afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit te të njëjtit, Gjykatës se Apelit ne Prishtinë, e përmes kësaj gjykate